



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 34 prot.

Kamëz, më 11.3.2022

V E N D I M

Nr. 30 Datë 11 / 3 2022

MBI

“ MIRATIMIN E PAGESËS SË QIRASË SIPAS VLERËS SË TREGUT TË LIRË, PËR FAMILJET E EVAKUARA NGA BANESAT E TYRE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019 “

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 11.03.2022 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendim Nr.27 Datë 9.03.2022** në mbështetje të nenit 113, pika 2, të kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “ Për mbrojtjen civile ”, Aktit Normativ nr. 8, datë 7.12.2019 të Këshillit të Ministrave “ Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019 “, Aktit Normativ nr.37 datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave “ Për disa ndryshime të aktit normativ nr. 8 datë 07.12.2019 të Këshillit të Ministrave “ Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019 “, nenit 26, të Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore “, miratuar me ligjin nr. 97/2019, vendimit nr.132, datë 22.12.2021 të Këshillit Bashkiak, “ Për miratimin e detajimi të buxhetit të Bashkisë Kamëz për vitin 2022-2024; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e pagesës e plotë të qirasë sipas vlerës në tregun e lirë, për individët/familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, sipas listës bashkë-lidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Afati i pagesës së qirasë mujore për familjet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, fillon nga muaji Mars 2022 *deri në momentin që familjet futen në shtëpi, siç përcaktohet në Aktin Normativ nr.37 datë 24.12.2020.*
3. Drejtorja e Emergjencave Civile dhe Strehimit do të kordinojë punën me Njësitë Administrative/Lagjet dhe Drejtorinë e Rindërtimit për monitorimin e pagesës së qirasë

Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza”, Nr. 492, Kamëz Tel: +355 47 200 177 E-mail: keshilli.bashkiak@kamza.gov.al, web: www.kamza.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

për familjet përfituese, si edhe njofton strukturat përgjegjëse për ndërprerjen e kësaj pagese, në rast se këto familje sistemohen përfundimisht në një banesë ose gjatë monitorimit, konstatohet se nuk përmbushin më kushtet për të përfituar pagesën sipas legjislacionit në fuqi.

4. Efektet financiare, do të përballohen nga fondi i kushtëzuar nga Qeverisja Qëndrore “Subvencionim i qirasë për familjet e prekura nga tërmeti”.
5. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit si dhe Drejtoria e Financave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
Bashkëngjitur këtij vendimi gjendet lista e familjeve përfituese.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
Hysen Koldashi

